

AKT THEMELIMI

I Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

“AISEN TEXTILE”

Bazuar në nenin 230 e vijues të Ligjit 9901, datë 14.04.2008, “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe ligjit nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit” me vullnetin tim të lirë dhe të shprehur me nënshkrimin e këtij Akti, sot ditën e martë 23 maj 2023, unë themeluesi:

-Z/Antonio Hoxha, i datëlindjes 18.01.1992, lindur në Berat, i identifikuar me kartën e identitetit me numër personal J20118083A, letër njoftim nr.038660494, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Deklaroj se:

Kam vendosur të nënshkruaj këtë Akt Themelimi për krijimin e shoqërisë tregtare private “**AISEN TEXTILE**”, me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k), më poshtë referuar “shoqëria” aktiviteti i të cilës rregullohet nga Akti i Themelimit dhe Statuti i shoqërisë, duke respektuar kërkesat e legjislacionit shqiptar në përgjithësi dhe të ligjit “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare” në vecanti.

Akti i themelimit të shoqërisë “**AISEN TEXTILE**” Sh.p.k është hartuar mbi bazën e këtyre principeve:

NENI 1

Forma dhe Emri

Shoqëria ka formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale SH.P.K., dhe i përballon humbjet deri në kufirin maksimal të vlerës së kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar. Emri i shoqërisë është “**AISEN TEXTILE**” Sh.p.k.

NENI 2

Baza Ligjore

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit” dhe Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

NENI 3
Selia Ligjore

Selia dhe qendra e kësaj shoqërie është në adresën: **Rruga "Antipatrea", "Lagjja "Barrikada", ndërtesa me nr.19/164, Ish Kombinati i Tekstileve, Zona Kadastrale Nr.8501, BERAT.**

Me adresën e mësipërme do të identifikohet qendra e personit juridik. Me vendim të Asamblesë së Ortakëve mund të hapen degë, filiale, agjensi ose përfaqësi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë sipas fushave në të cilat e ushtron veprimtarinë shoqëria.

NENI 4
Kohëzgjatja dhe prishja e shoqërisë

Shoqëria tregtare krijohet për të zhvilluar aktivitetin e saj për një afat të kohor të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent Qendra Kombëtare e Biznesit. Shoqëria prishet dhe kalon në procedurë likuidimi me vendim të Asamblese së Ortakëve, si dhe në rastet e tjera të parashikuara në ligj.

NENI 5
Objekti i veprimtarisë

Shoqëria "AISEN TEXTILE" Sh.p.k. ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Fasoneri. Rrobaqepësi të konfeksioneve të ndryshme për të rritur dhe fëmijë. Prodhim, përpunim, ambalazhim dhe tregtim të cdo lloji të lëndës së parë, gjysëm produkti dhe produkti të gatshëm të tekstileve dhe konfeksioneve.

Përpunimin e lëndëve të para dhe materialeve tekstile në proceset e: prerjes, qepjes, montimit të aksesorëve, hekurosjes, etiketimit dhe ambalazhimit për cdo lloj produkti tekstil e konfeksione në sektorin e veshjeve për llogari të vet dhe të tretëve për shërbimet fason. Hapje linjash të ndryshme prodhimi, hekurosje, etiketimi, ambalazhimi, numërimi, peshimi të mallrave konfeksioneve dhe tekstileve .

Import-eksport i lëndëve të para tekstile për llogari të vet dhe të tretëve, shitblerje konfeksione tekstile.

Import-Eksport i makinerive dhe pajisjeve të industrisë tekstile. Blerje e shtitje të tyre si edhe marrje dhe dhënie me qera.

Import-Eksport i produkteve që shoqëria do të prodhojë sipas kërkesave të klientëve vendas dhe të huaj mirëmbajtjen dhe shërbimin për mënyrën e përdorimit të produkteve si edhe garancitë e përcaktuara sipas marrëveshjes së lidhur midis klientëve dhe shoqërisë sonë. Konsulencë për klientët për mënyrën e përdorimit dhe funksionimit të produkteve të shitura.

NENI 6
Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “AISEN TEXTILE” është në masën 200.000 Lek (dyqind mijë), i ndarë në 1 (një) kuotë që zotërohet nga ortaku i vetëm i shoqërisë:

1- Antonio Hoxha 200.000 Leke (dyqindmijë) 100 %

Kapitali themeltar i shoqërisë do të shlyhet tërësisht dhe depozohet në një llogari të hapur në emër të shoqërisë në një nga bankat e nivelit të dytë pasi shoqëria të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 7
Aktet e Shoqërisë

Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij akt-themelimi edhe me norma të percaktuara në statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërisë dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8
Organet Drejtuese

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shumë se një administrator. Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërisë “AISEN TEXTILE” Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numër. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohëzgjatja dhe kompetencat e tyre.

Administrator i shoqërisë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë rizgjedhje është emëruar ortaku **Z/Antonio Hoxha**, i datëlindjes 18.01.1992, lindur në Berat, i identifikuar me kartën e identitetit me numër personal J20118083A, letër njoftim nr.038660494, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

NENI 9
Dispozitat e fundit

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me Statutin dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në Statut, do të aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare si dhe legjislacioni shqiptar në përgjithësi.

Shoqëria do të ketë vulën, stemën, logon dhe faqen e internetit (website), format dhe madhësitë do të përcaktohen nga Asambleja e Ortakëve në veçanti dhe me propozim të Administratorit.

Çdo mosmarrëveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet

AKT THEMELIMI “AISEN TEXTILE” SHPK

kompetente për gjykimin e mosmarre -veshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat.

Ky Akt Themelimit është hartuar në 3 (tre) ekzemplare, duke patur secili ekzemplare fuqi të njëjtë ligjore

**Ortaku i vetëm i
Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
“AISEN TEXTILE” Sh.p.k**

ANTONIO HOXHA

Berat,më 23.05.2023